



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 17
Prishtinë, më 21.08.2012, në orën 11.00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në këtë mbledhje morën pjesë: Suzana Novoberdaliu – kryetare, Rita Hajzeraj- Beqaj, Biserka Kostiq, Kurtan Kajtazi, Albana Gashi, Kimete Bytyçi, Duda Balje dhe Kymete Bajraktari.

Mungoi: Justina Pula.

Nga Staf i Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj - koordinator dhe Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

Të ftuar: Kryetari i Komunës së Podujevës, z. Agim Veliu.

Pjesëmarrës të tjerë: Nuredin Ibishi- CDF; Florije Kryeziu dhe Burim Tahiri-UNICEF, Visar Bivolaku dhe Ukë Gashi-ZPRK dhe Sanije Berisha-OSBE.

Mbledhjen e kryesoi, Suzana Novoberdaliu- kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara;
3. Shqyrtimi i planit të punës për gjashtëmuorin e dytë të vitit 2012;
4. Shqyrtimi i peticioneve;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja –I propozoj Komisionit që të ndryshoj rendin e ditës duke filluar me pikën e katërt të rendit të ditës për shkak se z. Agim Veliu është i ngarkuar me punë të tjera. Komisioni u pajtua me propozimin e kryetares dhe vendosi që të fillojë me pikën e katërt.

2. Miratimi procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara

Miratimi i procesverbaleve u shty për mbledhjen radhës për arsye se procesverbalet nuk kanë qenë të gatshme për shkak të pushimeve.

4. Takim me Agim Velin, lidhur me peticionin e Këshillit Organizativ të fshatit Orllan

Kryetarja – E përshëndeti kryetarin e Komunës së Podujevës, z. Agim Velin, dhe e njoftoi lidhur me dëgjimin që e ka pasur Komisioni me Këshillin Organizativ të fshatit Orllan, lidhur me kërkesat e tyre për mungesën e ujit dhe kanalizimit.

Këshilli Organizativ i këtyre fshatrave ka kërkuar që të ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme për zgjidhjen e problemit me ujë të pijshëm dhe ndërtimin e kanalizimit, në mënyrë që të mos derdhen ujërat e zeza në Liqenin e Batllavës.

Ajo ftoi kryetarin që ta marrë fjalën.

Agim Veliu, kryetar i Komunës së Podujevës, -E falënderoi Komisionin për ftesën dhe e njoftoi në vija të trasha lidhur me kërkesat e Këshillit Organizativ të fshatit Orllan me rrethinë. Ai në këtë drejtim tha se këto fshatra nuk kanë rrjet të kanalizimit dhe se projekti i tillë përmban kosto të madhe dhe është i papërbalueshëm për Komunën e Podujevës.

Këto fshatra kanë një konfiguracion të vështirë dhe se ky kanalizim do të shkonte përmes Liqenit. Pastaj ai ceku edhe problemin e pronave të cilat janë kontestuese me KEK-un duke kërkuar leje, si dhe kërkohet buxhet për kompensimin e shpronësimeve.

Deri me tani kjo çështje është ngritur në nivelet më të larta institucionale dhe vetë, sa isha deputet, këtë çështje e kam ngritur edhe në Kuvendin e Kosovës. Mirëpo deri me tani ka mbetur e parealizueshme. Projekti është i kushtueshëm, sepse uji duhet të merret nga fshati Shajkoc, ndërsa uji nuk mund të shkojë me rënie të lirë në Orllan. Ai duhet të shkojë përmes sistemit të pompimit.

Komuna nuk ka mundësi buxhetore ta zgjidhë këtë problem, por kërkohet edhe ndihma me bashkëfinancim nga ana e Qeverisë së Kosovës dhe Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor.

Kymete Bajraktari - Duke u ndërlidhur me bisedën pyeti se sa janë nën kontroll shkollat dhe sa është i pijshëm uji nëpër shkolla dhe si është çështja e kanalizimit, ajo po ashtu pyeti se sa është aktiv inspektorati i komunës kur i lejon ndërtimet pa leje në këto zona, dhe se a ka projekt për ujësjellës dhe pasi që Nuredini e paska ofruar një projekt, është mirë të interesoheni për këtë projekt.

Kimete Bytyçi –falënderoj kryetarin për prezencën, thatë se është ndare një shumë nga Kuvendi Komunal, sa është shuma e mjeteve që keni ndarë për ndërtimin e ujësjellësit si Komunë.

Lidhur me projektin shtruan pyetje Suzana Novoberdaliu, Kurtan Kajtazi, Rita Hajzeraj dhe Duda Balje, rreth financimit, mundësive buxhetore, kostos buxhetore, dhe të gjitha pyetjeve kryetari i Komunës së Podujevës ju përgjigj me ç’ rast deputetët u pajtuan me përgjigjet e ofruara.

Ndërsa **Duda Balje**- I njoftoi se edhe komuniteti boshnjak, që ka rreth 30 fshatra ballafaqohet me të njëjtin problem. Prandaj i sugjeroj kryetarit të merr nismën nga Komuna dhe të fillojë ndërtimin e ujësjellësit dhe kanalizimit, sepse pa projekt as qeveria e as organizatat e tjera nuk mundën t’ ju ndihmojnë në këtë çështje.

Kryetarja – E falënderoi kryetarin e Komunës së Podujevës për informacionet dhe sqarimet që ju ofroi anëtarëve të këtij komisioni.

3. Shqyrtim i Planit të Punës së Komisionit për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2012

Kryetarja – I njoftoi se e kanë për shqyrtim Planin e Punës pas muajit gusht, pra pas pushimit veror, por ajo tha se i kemi edhe disa aktivitete në korrik që nuk janë realizuar, ndërsa ishte e mendimit se shqyrtimi i buxhetit të bëhet më herët se sa në muajin dhjetor. Sa i përket vizitave në terren lidhur me të drejtat e fëmijëve, ajo e kërkoi mendimin e zyrtarëve të UNICEF – it lidhur me hartimin e një plani lidhur me realizimin e këtyre vizitave.

Komisioni lidhur me hartimin e një Plani të Punës për aktivitetet e Komisionit në monitorimin e realizimit të drejtave të fëmijëve unanimisht vendosi të nxjerrë këtë:

Përfundim

Komisioni formoi Grupin Punues i cili do të merret ekskluzivisht me këto çështje dhe më pas do t’ia paraqesë Komisionit. Kryetare e këtij grupi punues u zgjodh Kimete Bytyqi ndërsa anëtarë u zgjodhën Rita Hajzeraj – Beqaj dhe Kymete Bajraktari.

3. Të ndryshme.

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzana Novoberdaliu